



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:127428

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05539207

CP.nr.1041/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbartimore të kreditorit S.Sh. te cilin e përfaqëson me autorizim avokat Valon Mehmeti, me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit T. Sh. a. - Mitrovicë, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi Cnr.1037/2020, te datës 22.04.2021, të lejuar me aktvendimin për përmbartim CP 1041/21, te datës 01.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 03.04.2024 morri ketë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e udhëhequr sipas shenjës CP 1041/21, me kreditor S. Sh., T. Sh. a. –Mitrovicë, ndaj debitorit T. Sh. a. – Mitrovicë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditori i përmbartimit S. Sh. te cilin e përfaqëson me autorizim avokat Valon Mehmeti, me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit T. Sh. a. – M., ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi Cnr.1037/2020, te datës 22.04.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbartimit, me aktvendimin CP 1041/21, te datës 01.09.2021, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit T.Sh. a. – M

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 1041/21, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt.25.03.2024, ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbartimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbartim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbartimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë*

se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CP.nr.1041/2021 më datë 03.04.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimin të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.